10134
12.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

R E L A C I O N

KËSHILLIT BASHKIAK

MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2025 NË TRANSFERTËN E PA KUSHTËZUAR ,MIRATUAR ME VKB NR.112 DATË.26.12.2024

Të nderuar Këshilltarë!

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën e saj nr.14505/11, datë 24.10.2025, në zbatim të Aktit Normativ nr.10, date 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", të ndryshuar ka dërguar detajimin e shtesës së fondeve për njesitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në shumën 1,860,000 lekë.
Në shkresën sqarohet se: Fondi akordohet për të ndihmuar Bashkitë për shpërblimin e punonjesve të angazhuar në shuarjen e zjarreve, në masën deri në një pagë. Kriteret e shpërndarjes se shpërblimit janë të përcaktuara në pikën 3 te VKM-së nr.483 datë 02.09.2025 "Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025". Bashkitë të cilat kanë akorduar shpërblimin e punonjësve të mbrojtjës nga zjarri dhe shpëtimi nga buxheti i tyre do ta përdorin ketë fond për të rritur cilësinë e shërbimit në ketë sektor.

Nisur nga llogaritjet dhe analiza e programit, paraqesim ndarjen e këtij fondi sipas tabelës bashkëlidhur.

Institucioni	Programi	Gr	Kapitulli	Produkti	Vlera	Artikulli 600	Artikulli 601	Artikul 602
2129001	AA129	00	01	V328AAB	1,500,000	1,293,103.50	206,896.50	
2129001	AA129	00	01	V328AAC	360,000			360,000.
Shuma Bashkia Lushnje					**1,860,000.00**	**1,293,103.50**	**206,896.50**	**360,000.**

Ju faleminderit!

Për Drejtorinë e Financë–Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
Erisa Qallin

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 10134/1 Prot

Lushnje, më 12.11 2025

PROJEKT VENDIM

Nr 101 Datë 12 .11.2025

MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2025 NË TRANSFERTËN E PA KUSHTËZUAR ,MIRATUAR ME VKB NR.112 DATË.26.12.2024

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____.11.2025, pasi analizoi relacionin e paraqitur "Mbi një shtesë në buxhetin e vitit 2025 (Transferta e pakushtëzuar) miratuar me VKB nr.112 datë.26.12.2024", si dhe në Zbatim të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore, neni 54/dh, Ligjit nr.68/ 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 23 paragrafi 'Transferta e pakushtëzuar", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat Standarte të zbatimit të buxhetit", të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2025", dhe ligjit nr Ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", si dhe në shkresën e dërguar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore me nr.145505/11, datë 24.10.2025

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë shtesën e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2025 me 1,860,000 lekë. (Si pjesë e transfertës së pakushtëzuar) sipas tabelës.

Institucioni	Programi	Gr	Kapitulli	Produkti	Vlera	Artikulli 600	Artikulli 601	Artikulli 602
2129001	AA129	00	01	V328AAB	1,500,000	1,293,103.50	206,896.50	
2129001	AA129	00	01	V328AAC	360,000			360,000.00
Shuma Bashkia Lushnje					**1,860,000.00**	**1,293,103.50**	**206,896.50**	**360,000.00**

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

3. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për Drejtorinë e Financë–Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

Për Drejtorinë Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com